



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI

Nr.184/4. prot

Tepelenë më, 01.02.2023.

V E N D I M

NR.4.DATË 31.01.2023

“PËR

“MIRATIMI I KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR MBI PROGRAMIN E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND OSE ME FONDET E BUXHETIT VENDOR”.”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 115/2021, “Per buxhetin e vitit 2022”.Vendimit nr. 597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave . “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” i ndryshuar me vendimin nr 868 date 29.12.2021; udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për përfitimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind” (I ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, Këshillit Bashkiak :

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor.
2. Familjet në nevojë përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar dhe kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur fitues.
3. Numri i familjeve përfituese do të jetë i barabartë për çdo njësi administrative. Nëse Njësia Administrative nuk plotëson numrin e familjeve në nevojë, struktura përgjegjëse për shërbimet Sociale në Bashki do të vlerësojë familjet më në nevojë nga njësitet e tjera administrative. Prioritet do të kenë familjet me nevoja sociale ekonomike të theksuara.
4. Të miratojë **procedurat** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendo
5. Sipas pikës 4 të këtij vendimi, Njësia Administrative përpunon listën e përfituesve të mundshëm dhe vlerëson dosjet për t’u trajtuar me këto fonde dhe përcjell pranë Drejtorisë ligjore /Sektorit të Shërbimeve Sociale listën e përfituesve të mundshëm dhe dokumentacionin e duhur dhe të plotë.

...Administrative propozon masën e ndihmës ekonomike për çdo familje, në mbështetje të udhëzimit ... datë 17.12.2017 të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për për llogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.

7. Në zbatim të këtij vendimi struktura përgjegjëse për shërbimet Sociale në Bashki në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve Social Ekonomike të ardhura nga njësitë administrative për trajtim me ndihmë ekonomike, shqyrton, vlerëson dosjet sipas kriterëve, procedurave dhe sistemit të pikëzimit, si dhe harton projekt vendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e Bashkisë.
8. Të miratojë **dokumentacionin mbi përdorimin** e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, si më poshtë:
 - a. Vlerësim Social Ekonomik.
 - b. Fletë përmbledhje e daljes nga sistemi pikëzimit.
 - c. Vërtetim KMCAP.
 - d. Fotokopje e çertifikatës familjare
 - e. Fotokopje e kartës së identitetit.
 - f. Vërtetim nga zyra e pune si I pa punë .
9. Të miratojë **sistemin e pikëzimit** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, sipas *aneksit nr.1*, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
10. Familjet e përzgjedhura do të përfitojnë ndihmën ekonomike nga programi i bllok-ndihmes 6% ose fondi i vënë në dispozicion nga Bashkia Tepelenë në programin e kujdesit social projekti “Mbrojtja sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike” në buxhetin e vitit 2023.
11. Ngarkohen Drejtoria ligjore /sektori I Ndhmës ekonomike dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.


Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 13(trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13(trembëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 01.02.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU





ANEKSI 1
SISTEMI I PIKEZIMIT PER PROGRAMIN E FONDIT TE KUSHTEUAR MBI PROGRAMIN E BLOK NDIHMES EKONOMIKE DERI NE 5% OSE ME FONDE TE BUXHETIT VENDOR

Emri, Atesia, Mbiemri	Perberja familjare (nr i frymeve)		1		2		3	4	5	6	7	8
	vleresim social ekonomik familjes	rurale /urbane	statu civil	si familjar	mosha e femijeve	kushlet e jeteses						
							mbi/nen 18 vjec		Te ardhurat mbi/nen 8000 leke			TOTALI

TE ARDHURAT
 MBI 8000 LEKE 5 PIKE
 NEN 8000 LEKE 10 PIKE

PIKEZIMI
GJENDJA FAMILJARE
 ME FEMIJE NEN 18 VJEC 10 PIKE
 ME FEMIJE MBI 18 VJEC 5 PIKE
 IVE/DIVORCUAR/VEÇUAR 10 PIKE
 PAK K/FAMILJAR 10 PIKE
 PAK FAMILJAR 5 PIKE

VLERESIMI SOCIAL EKONOMIK
 FAMIJE RURALE 5 PIKE
 FAMIJE URBANE 5 PIKE
 ME PASURI PALUAJTSHME 5 PIKE
 PA PASURI PALUAJTSHME 10 PIKE